



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 31 datë 07.05 2026

**PËR “PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIDHUR ME VKM-NË NR. 329, DATË 22.5.2019, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI” DHE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT PËR 2 (DY) FAMILJE**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM Nr.329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi” dhe në Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” neni 83 i tij, si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI:**

1. Të përfundohen procedurat për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit të noteri lidhur me VKM Nr.329 datë 22.05.2019 për 2 (dy) familjet si më poshtë :
  - a) Fuat FICO
  - b) Roland FICO
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit të Territorit/Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Aleks TANE

